

Pozita e kryerësve të veprave penale sipas rregullores nr. 2004/34 “Mbi procedurën penale ku përfshihen kryerës me çrregullime mendore”

I. Vështrime hyrëse

Pas përfundimit të luftës në Kosovë dhe vendosjen e saj nën administrimin e Misionit të Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara (UNMIK), në Kosovë filluan hapat e parë në ndërtimin e shtetit ligjor dhe vendosjen e sundimit të ligjit në shoqëri. Në periudhën e pasluftës, Kosova është ndeshur me një vakum ligjor dhe institucional, si pasojë e mungesës së ligjeve vetanake. Kështu, si rezultat i krijimit të realitetit të ri juridiko-politik në Kosovën e pasluftës, dhe me qëllim të plotësimit të zbrazëtirës juridike, Misioni i Administratës së Kombeve të Bashkuara fillon të nxjerrë akte juridike përkatëse në formë të rregulloreve.¹ Por, njëkohësisht u shtrua edhe nevoja e ndërtimit të legjislacionit të ri kosovar që do të jetë në pajtim me standardet ndërkombëtare të vendeve të zhvilluara. Në kuadër të këtij legjislacioni që do të përgatitej një rëndësi të madhe kishin aktet juridike të fushës penale. Në këtë drejtim, si rezultat i një pune të përbashkët të ekspertëve vendës dhe atyre ndërkombëtarë janë përgatitur dhe miratuar kodet dhe ligjet të fushës juridiko-penale, të procedurës penale dhe të asaj peniten-

¹ Ndër rregulloret e para në këtë drejtim konsiderohet Rregullorja nr.1999/1, e datës 25 korrik 1999 “Mbi autoritetin e administratës së përkohshme në Kosovë”. Ndërkaq, me Rregulloren nr.1999/24, të datës 12 dhjetor 1999 “Për ligjin në fuqi në Kosovë”, Legjislacioni në fuqi në Kosovë përfshin: Rregulloret e shpallura nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm (PSSP) të OKB-së dhe instrumentet ndihmëse të nxjerra në përputhje me to, si dhe Legjislacioni në fuqi në Kosovë më 22 mars 1989. (Shih neni 1 pika 1.1 të kësaj Rregulloreje).

siare si: Kodi i Përkohshëm Penal i Kosovës,² Kodi i Përkohshëm i Procedurës Penale i Kosovës,³ Kodi i Drejtësisë për të Mitur i Kosovës,⁴ Ligji për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale⁵ dhe disa rregullore të UNMIK-ut në fushat e përmendura. Në kuadrin e këtyre rregulloreve, pa dyshim se një rëndësi të madhe e ka edhe Rregullorja nr.2004/34 "Për Procedurën Penale ku përfshihen kryerës me çrregullime mendore".⁶

Deri me hyrjen në fuqi të Rregullores nr. 2004/34 "Për Procedurën Penale ku përfshihen kryerës me çrregullime mendore", dispozitat juridike të cilat u referohen llojeve dhe kushteve të shqiptimit të masave të trajtimit të detyrueshëm psikiatrik ndaj kryerësve me çrregullime mendore, të procedurës penale ku përfshihen kryerësit e tillë si dhe të ekzekutimit të masave ndaj tyre ishin të parapara me Ligjin Penal të ish RSFJ-së,⁷ Ligjin për Procedurën Penale,⁸ Ligjin për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale⁹ dhe me dispozita të tjera përkatëse.

Rregullorja nr. 2004/34 "Për Procedurën Penale ku përfshihen kryerës me çrregullime mendore" ka një rëndësi të madhe për sistemin juridiko-penal, procedural dhe atë penitenciar të Kosovës. Me këtë rregullore për herë të parë në historinë e Kosovës rregullohet në mënyrë të pavarur fusha e trajtimit të pozitës së kryerësve të veprave penale me çrregullime mendore. Kjo rregullore përmban dispozita të natyrës materiale, të procedurës penale dhe të ekzekutimit të masave të trajtimit të detyrueshëm psikiatrik ndaj kryerësve me çrregullime mendore. Me miratimin e kësaj rregulloreje, dispozitat lidhur me masat e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik ndaj kryerësve me çrregullime mendore, të procedurës penale si dhe të ekzekutimit të masave ndaj tyre tashmë janë të sistemuara në një akt juridik të vetëm, duke shënuar në këtë mënyrë edhe ndarjen e trajtimit të pozitës së kryerësve me çrregullime mendore nga kryerësit normal. Me këtë rregullore janë përfshirë shumë zgjidhje parimore dhe solucione nga dispozitat e legjislacioneve të shteteve të zhvilluara bashkëkohore. Gjatë

² Rregullorja e UNMIK-ut nr.2003/25, të datës 6 korrik 2003.

³ Rregullorja e UNMIK-ut nr.2003/26, të datës 6 korrik 2003.

⁴ Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2004/8, të datës 20 prill 2004.

⁵ Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2004/46, të datës 19 nëntor 2004.

⁶ Kjo Rregullore është shpallur më 24 gusht të vitit 2004 dhe është publikuar në Gazetën Zyrtare të Misionit të Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë, Vëllimi 8/2004.

⁷ Ky ligj është zbatuar nga 1 korriku 1977 e deri me hyrjen në fuqi të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës.

⁸ Ky ligj është zbatuar nga 1 korriku 1977 e deri me hyrjen në fuqi të Kodit të Përkohshëm të Procedurës Penale të Kosovës.

⁹ Ky ligj është zbatuar nga 1 korriku 1977 e deri me hyrjen në fuqi të Ligjit mbi ekzekutimin e sanksioneve penale.

hartimit të saj kanë gjetur aprovim edhe një mori standardesh dhe kërkesash të disa konventave dhe akteve të njohura ndërkombëtare, të cilat u referohen pozitës së kryerësve me çrregullime mendore.¹⁰

Rregullorja nr.2004/34 “Për Procedurën Penale ku përfshihen kryerës me çrregullime mendore” është e sistemuar në nëntë kapituj, që përfshijnë dispozita të rëndësishme në fushën e trajtimit të pozitës së kryerësve me çrregullime mendore. Në vijim të këtij punimi do të paraqesim dhe trajtojmë shkurtimisht pozitën e kryerësve me çrregullime mendore sipas kësaj rregulloreje, duke u mbështetur në sistemimin dhe përmbajtjen e saj.

II. Pozita e kryerësve të veprave penale sipas Rregullores nr. 2004/34 “Për Procedurën Penale ku përfshihen kryerës me çrregullime mendore”

Rregullorja nr.2004/34 “Për Procedurën Penale ku përfshihen kryerës me çrregullime mendore” përbëhet prej nëntë kapitujve, të cilët përbëjnë dispozita të rëndësishme të trajtimit të pozitës së kryerësve me çrregullime mendore. Këto dispozita kanë të bëjnë me llojet e masave të zbatueshme dhe sanksioneve penale që mund të shqiptohen ndaj kryerësve me çrregullime mendore, me zhvillimin e procedurës penale ndaj tyre si dhe me ekzekutimin e masave për trajtim të detyrueshëm psikiatrik. Respektivisht, sistemimi i kësaj rregulloreje është bërë si vijon: Kapitulli I: Dispozitat e përgjithshme; Kapiulli II: Masat e zbatueshme për kryerësit me paaftësi mendore ose me aftësi të zvogëluar mendore; Kapitulli III: Procedura paraprake; Kapitulli IV: Procedura në rastin e paaftësisë për t’iu nënshtruar gjykimit; Kapitulli V: Procedura për rastet e paaftësisë mendore në kohën e kryerjes së veprës penale; Kapitulli VI: Procedura në rastin e aftësisë së zvogëluar mendore në kohën e kryerjes së veprës penale; Kapitulli VII: Ekzekutimi i masave për trajtim të detyrueshëm psikiatrik; Kapitulli VIII: Dispozitat kalimtare; Kapitulli IX: Dispozitat përfundimtare.

¹⁰ Në këtë drejtim shih: Tërësia e rregullave minimum për trajtimin e të burgosurve, Rregulli 82 dhe 83, Botuar në: Përmbledhje aktesh ndërkombëtare, Tiranë, 1994, fq.177-178; etj. Ndërkaq, Këshilli i Evropës në vitin 2000 ka hartuar të ashtuquajturën “Letrën e bardhë” për mbrojtjen e të drejtave dhe dinjitetit njerëzor të personave që lëngojnë nga shëndeti mental (“White Paper” on the protection of the human rights and dignity of people suffering from mental disorder, specialty those placed as involuntary patients in a psychiatric establishment).

Në kapitullin e parë të kësaj rregulloreje gjenden dispozitat që kanë të bëjnë me përkufizimet dhe nocionet që janë përdorur në tekstin e saj si dhe dispozitat që u referohen parimeve të përgjithshme. Qysh në nenin 2 të kësaj rregulloreje shtrohet kërkesa që kryerësit me çrregullime mendore të trajtohen me humanizëm dhe të gjejë vend në masën sa më të madhe zbatimi i standardeve ndërkombëtare për kryerësit e tillë. Kësisoj, sipas paragrafit 1 të nenit 2 *“Kryerësi me çrregullime mendore ose personi i cili trajtohet si i tillë, trajtohet me humanizëm dhe respekt të dinjitetit që i takon si qenie njerëzore”*. Ndërkaq, në paragrafin 2 të këtij neni thuhet: *“Standardet ndërkombëtare të zbatueshme për personat me çrregullime mendore zbatohen për kryerësit me çrregullime mendore në shkallën më të lartë të mundshme, me vetëm disa ndryshime dhe përjashtime të kufizuara varësisht nga nevojat dhe rrethanat”*. Siç mund të vërehet, me këtë nen janë akceptuar parime dhe koncepte të avancuara nga konventat dhe rregullat e njohura ndërkombëtare që trajtojnë pozitën e kryerësve me çrregullime mendore.

Dispozitat që u referohen llojeve të masave të zbatueshme dhe sanksioneve penale ndaj kryerësve me paaftësi mendore ose me aftësi të zvogëluar mendore si dhe arsyet për shqiptimin e masave janë paraparë në kapitullin e dytë të kësaj rregulloreje. Sipas nenit 3 paragrafi 1 të kësaj rregulloreje, si masa të cilat mund të shqiptohen ndaj kryerësit i cili ka kryer vepër penale në gjendje të paaftësisë mendore ose në gjendje të aftësisë së zvogëluar mendore janë: a) *Trajtimi i detyrueshëm psikiatrik me ndalim në institucion të kujdesit shëndetësor (“trajtimi i detyrueshëm psikiatrik me ndalim”)* dhe b) *Trajtimi i detyrueshëm psikiatrik në liri*. Në të drejtën penale bashkëkohore mbizotëron mendimi se me masat e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik synohet të arrihen dy funksione themelore: evitimi i rrezikut që personat e këtillë sërish të kryejnë vepra penale si dhe arritja e objektivit të humanizimit të së drejtës penale dhe të politikës ndëshkimore në përgjithësi.¹¹ Ndaj kryerësve të këtillë, e veçmas ndaj kryerësve me paaftësi mendore do të ishte e padrejtë dhe johumane që të shqiptohen dënime, pasi që ata në kohën e kryerjes së veprës penale kanë lënguar nga ndonjë sëmundje mendore e përkohshme ose e përhershme, ose kanë pasur çrregullim mendor apo ngecje në zhvillimin mendor, që ka pasur për pasojë që ata të mos jenë në gjendje t’i kuptojnë ose t’i kontrollojnë veprimet ose mosveprimet e tyre apo të kuptojnë se kryejnë vepër penale. Ndërkaq, sanksioni penal sipas paragrafit 2 të këtij neni mund të shqiptohet në pajtim me Kodin e Përkohshëm Penal ndaj kryerësit me aftësi të zvogëluar mendore nëse ekzistojnë arsyet për shqiptimin e tij. Kryerësi i tillë, siç dihet, në të drejtën penale konsiderohet penalisht i përgjegjshëm, por rrethana se ai në kohën e

¹¹ I.Salihu, E drejta penale (Pjesa e përgjithshme), Prishtinë, 2003, fq.524.

kryerjes së veprës penale ka aftësi dukshëm të zvogëluar për të kuptuar veprën penale apo për t'i kontrolluar veprimet apo mosveprimet e tij, merret parasysh nga gjykata kur vendos për kohëzgjatjen dhe llojin e sanksionit penal ose masën për trajtimin e detyrueshëm.

Në nenet 4 dhe 5 të kësaj rregulloreje janë parashikuar arsyet e shqiptimit të trajtimit të detyrueshëm psikiatrik. Masat e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik shqiptohen ndaj kryerësit të veprës penale me paaftësi mendore ose aftësi të zvogëluar mendore nëse konstatohet se: a) *ekziston rreziku serioz që kryerësi të kryejë veprë penale ku përfshihet akti i dhunshëm ose shkaktimi i lëndimit trupor personit tjetër; si dhe b) trajtimi i detyrueshëm psikiatrik është i nevojshëm për shmangien e rrezikut të tillë*. Si arsye shtesë për shqiptimin e masës së trajtimit të detyrueshëm psikiatrik me ndalim kërkohet që kryerësi të ketë kryer veprë penale të dënueshme më së paku tri vite burgim në gjendje të paaftësisë mendore ose aftësisë së zvogëluar mendore. Siç mund të vërehet, trajtimi i detyrueshëm psikiatrik me ndalim është masë më e rëndë dhe kërkon qëndrimin e pandërprerë të kryerësit në institucionin e kujdesit shëndetësor, prandaj edhe mund të shqiptohet ndaj kryerësve që kanë kryer vepra penale më të rënda se sa kategoritë tjera të kryerësve me çrregullime mendore.

Dispozitat më të shumta të Rregullorës nr.2004/34 "Për Procedurën Penale ku përfshihen kryerës me çrregullime mendore" kanë të bëjnë me zbatimin e procedurës penale ndaj kryerësve të cilët kanë kryer vepra penale në gjendje të paaftësisë mendore ose në gjendje të aftësisë së zvogëluar mendore. Këto dispozita janë parashikuar në kapitujt III-VI të kësaj rregulloreje dhe ato e avancojnë dukshëm pozitën e personave me çrregullime mendore në krahasim me legjislacionin e mëparshëm. Mund të thuhet me të drejtë se në kuadër të këtyre kapitujve kanë ardhur në shprehje shumë standarde dhe zgjidhje bashkëkohore të cilat janë të njohura në shtetet e zhvilluara. Këto standarde dhe kërkesa bashkëkohore janë në përputhje të plotë me konceptin, brendinë dhe qëllimin e masave të trajtimit të detyrueshëm psikiatrik. Prandaj, edhe zbatimi i procedurës penale duhet të jetë në përputhje me kërkesat e përmendura më lartë. Dihet mirëfilli se masat e trajtimit të detyrueshëm në legjislacionet e shteteve të zhvilluara bashkëkohore nuk konsiderohen masa penale, ndëshkimore. Ato janë masa të trajtimit, të cilat kanë për qëllim mjekimin, ruajtjen dhe mbrojtjen e kësaj kategorie të kryerësve të veprave penale si dhe të mbrojtjes së shoqërisë nga rreziku i përsëritjes së veprave penale. Prandaj, ky koncept i masave të trajtimit të detyrueshëm psikiatrik, i përvetësuar në

këtë rregullore, është marrë sipas modeleve të kodeve penale të shteteve të zhvilluara dhe bazohet në të arriturat e shkencës së psikiatrisë.¹²

Që në fillim të kapitujve që kanë të bëjnë me zbatimin e procedurës ndaj kryerësve me çrregullime mendore, kjo rregullore parasheh mundësinë e ekzaminimit psikiatrik të gjendjes shëndetësore të personave me çrregullime mendore për konstatimin e gjendjes së aftësisë mendore ose të aftësisë së zvogëluar mendore në kohën e kryerjes së veprës penale apo edhe për të konstatuar aftësinë e tyre për t'iu nënshtruar gjykimit. Kështu, sipas kësaj rregulloreje, parashihet mundësia që në çdo kohë, përfshirë edhe kohën e shqyrtimit gjyqësor, nëse ekziston dyshimi se i pandehuri ka qenë në gjendje të paaftësisë mendore ose në gjendje të aftësisë së zvogëluar mendore në kohën e kryerjes së veprës penale apo nëse ka ndonjë çrregullim mendor, gjykata sipas detyrës zyrtare ose me propozimin e prokurorit publik apo të mbrojtësit, mund të caktojë ekspert për ekzaminimin psikiatrik të të pandehurit. Ky ekzaminim psikiatrik mund të caktohet për të konstatuar nëse: a) Në kohën e kryerjes së veprës penale i pandehuri ka qenë në gjendje të paaftësisë mendore ose të aftësisë së zvogëluar mendore; b) I pandehuri është i paaftë për të përballuar gjykimin (neni 6 paragrafi 1 i Rregullores nr.2004/34). Në urdhrin e lëshuar nga gjykata duhet të shënohet edhe koha e nevojshme për ekzaminim psikiatrik, i cili ekzaminim duhet të kryhet brenda dy javësh. Nëse për konstatimin e fakteve të përmendura më lartë ekspertit i nevojitet kohë më e gjatë, ose nëse i pandehuri refuzon ekzaminimin psikiatrik, eksperti mund të paraqesë kërkesë të arsyetuar gjykatës për vendosjen e të pandehurit në institucion të kujdesit shëndetësor. Në rastet e tilla gjykata vendos me aktvendim për ndalimin e të pandehurit në institucionin shëndetësor deri në dy javë, e cila periudhë mund të shtyhet edhe për dy javë të tjera. Nëse ndaj të pandehurit është caktuar paraburgimi, koha e kaluar në institucionin shëndetësor llogaritet në periudhën e paraburgimit (neni 6 paragrafi 6).

Në këtë rregullore parashihen edhe dispozitat që kanë të bëjnë me paraburgimin e personave me çrregullime mendore. Sipas nenit 7 paragrafi 1, paraburgimi mund të caktohet sipas dispozitave të nenit 281 të Kodit të Përkohshëm të Procedurës Penale, nëse në bazë të ekzaminimit psikiatrik personi ka qenë në gjendje të paaftësisë mendore ose në gjendje të aftësisë së zvogëluar mendore në kohën e kryerjes së veprës penale, dhe ai aktualisht vuan nga çrregullimi mendor, si rezultat i së cilës ekziston frika se ai do të rrezikojë jetën apo shëndetin e ndonjë personi tjetër. Natyrisht se paraburgimi i tillë mund të urdhërohet vetëm nëse prokurori

¹² Në legislacionin e mëparshëm penal, masat e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik janë emërtuar si masa sigurorese. (Shih nenet 63 dhe 64 të Ligjit Penal të ish RSFJ-së të vitit 1977).

publik ka paraqitur propozim për shqiptimin e masës së trajtimit të detyrueshëm psikiatrik dhe mbahet në institucionin e kujdesit shëndetësor.

Në kapitullin IV të kësaj rregulloreje gjenden dispozitat që kanë të bëjnë me zbatimin e procedurës për të vlerësuar aftësinë e të pandehurit për t'iu nënshtruar gjykimit. Sipas nenit 8 të kësaj rregulloreje, gjykata sipas detyrës zyrtare ose me kërkesë të mbrojtësit apo prokurorit publik merr aktvendim mbi aftësinë e të pandehurit për t'iu nënshtruar gjykimit pasi që më parë ka shqyrtuar mendimin e ekspertit dhe pas dëgjimit të prokurorit publik, mbrojtësit dhe të pandehurit. Ndërkaq, në paragrafin 2 të këtij neni shprehimisht thuhet: *"Gjykata vendos se i pandehuri është i paaftë për t'iu nënshtruar gjykimit nëse ai aktualisht ka çrregullim mendor dhe për shkak të çrregullimit të tillë mendor ai nuk është i aftë që të mbrohet, të konsultohet me mbrojtësin apo të kuptojë procedurën"*. Aktvendimi i gjykatës mbi aftësinë e të pandehurit për t'iu nënshtruar gjykimit mund të ankoheret. Në nenin 9 janë paraparë rastet e pushimit apo të ndërprerjes së procedurës varësisht nga zgjidhja që afron aktvendimi lidhur me aftësinë e të pandehurit për t'iu nënshtruar gjykimit. Në rastet kur gjykata vendos se i pandehuri është i paaftë për t'iu nënshtruar gjykimit gjatë procedurës për shkak të sëmundjes së përhershme mendore, ajo e pushon procedurën. Ndërkaq, nëse ajo konstaton se paaftësia mendore është rezultat i çrregullimit mendor të paraqitur pas kryerjes së veprës penale, atëherë ajo ndërpret hetimet ose e ndërpret shqyrtimin gjyqësor në pajtim me dispozitat e Kodit të Përkohshëm të Procedurës Penale.

Dispozitat që u referohen procedurës për rastet e paaftësisë mendore në kohën e kryerjes së veprës penale janë paraparë në kapitullin e V-të të kësaj rregulloreje. Sipas nenit 10, nëse i pandehuri ka kryer vepër penale në gjendje të paaftësisë mendore dhe nëse ekzistojnë arsyet për shqiptimin e masës së tillë, prokurori publik paraqet propozim që gjykata të shqiptojë masën e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik. Ndërkaq, në rastet kur provat e paraqitura në shqyrtimin gjyqësor dëshmojnë se i pandehuri e ka kryer veprën penale në gjendje të paaftësisë mendore, prokurori publik gjatë shqyrtimit gjyqësor e ndryshon aktakuzën dhe paraqet propozim që gjykata të shqiptojë masën e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik, kuptohet nëse ekzistojnë arsyet për shqiptimin e masës së tillë. I pandehuri duhet të ketë mbrojtës pas dorëzimit të propozimit. Në pajtim me nenin 11 të Rregullores nr.2004/34, masa e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik shqiptohet pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor nga gjykata që është kompetente për gjykimin e çështjes në shkallë të parë. Sipas paragrafit 2 të këtij neni, përveç personave të cilët duhet të thirren në shqyrtimin gjyqësor, duhet të thirren edhe ekspertët dhe psikiatrat nga institucioni i kuj-

desit shëndetësor të cilëve u është besuar kryerja e ekzaminimit psikiatrik si dhe njoftohen edhe bashkëshorti/ja e të pandehurit, prindërit e tij ose prindërit adoptues. Në nenin 12 të kësaj rregulloreje gjenden dispozitat që u referohen vendimeve gjyqësore që mund të merren në procedurën e shqiptimit të masës së trajtimit të detyrueshëm psikiatrik. Kësisoj, nëse gjykata konstaton se nuk ekzistojnë arsyet për shqiptimin e masës së trajtimit të detyrueshëm psikiatrik, ajo e pushon procedurën e shqiptimit të kësaj mase. Gjukata merr aktgjykim lirues për të pandehurin nëse ai ka qenë në gjendje të pafutësishme mendore kur e ka kryer veprën penale dhe po qe se prokurori publik nuk e ka paraqitur propozimin për shqiptimin e masës së trajtimit të detyrueshëm psikiatrik. Ndërkaq, gjykata merr aktvendim për shqiptimin e masës së trajtimit të detyrueshëm psikiatrik nëse ekzistojnë arsyet për shqiptimin e kësaj mase dhe nëse prokurori publik e ka paraqitur propozimin për shqiptimin e masës së trajtimit të detyrueshëm psikiatrik.

Në kapitullin VI të kësaj rregulloreje janë të sistemuara dispozitat që kanë të bëjnë me zbatimin e procedurës në rastin e aftësisë së zvogëluar mendore në kohën e kryerjes së veprës penale. Sipas nenit 13, masa e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik ndaj të pandehurit i cili ka kryer vepër penale në gjendje të aftësisë së zvogëluar mendore shqiptohet me aktgjykim, nëse ekzistojnë arsyet për shqiptimin e masës së tillë. Kjo masë mund të shqiptohet pavarësisht nëse i pandehuri ndodhet në liri apo ndaj tij është shqiptuar dënimi me burgim (neni 13 paragrafi 2). Ndërkaq, sipas paragrafit 3 të këtij neni, koha e kaluar në institucionin e kujdesit shëndetësor për ekzaminimin e të pandehurit, koha e qëndrimit të tij në paraburgim si dhe koha e qëndrimit sipas masës së trajtimit të detyrueshëm psikiatrik me ndalim, llogaritet në dënimin e shqiptuar.

Rregullorja nr.2004/34 "Për Procedurën Penale ku përfshihen kryerës me çrregullime mendore" përmban edhe dispozita të cilat trajtojnë ekzekutimin e masave për trajtim të detyrueshëm psikiatrik. Kësisoj, ajo veç e veç rregullon procedurën e ekzekutimit të masës së trajtimit të detyrueshëm psikiatrik me ndalim dhe të ekzekutimit të masës së trajtimit të detyrueshëm psikiatrik në liri. Në krahasim me legjislacionin e mëparshëm që u referohej ekzekutimit të masave të trajtimit të detyrueshëm psikiatrik, me këtë rregullore janë përfshirë risi dhe zgjidhje të avancuara të cilat kanë të bëjnë me pozitën e kryerësve me çrregullime mendore gjatë ekzekutimit të këtyre masave. Dispozitat të cilat kanë të bëjnë me ekzekutimin e masave për trajtim të detyrueshëm psikiatrik janë të sistemuara në kapitullin e VII të kësaj rregulloreje. Qysh në fillim të këtij kapitulli gjenden dispozitat të cilat parashohin obligimin e heqjes së zotësisë së

veprimet ndaj personave të cilëve u është shqiptuar masa e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik. Kësisoj, sipas nenit 14, vendimi i formës së prerë me të cilin është shqiptuar masa e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik me ndalim apo masa e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik në liri i dorëzohet gjykatës kompetente për të vendosur lidhur me heqjen e zotësisë së veprimit. Me këtë vendim duhet të njoftohet edhe Qendra kompetente për mirëqenie sociale.

Ekzekutimi i masës së trajtimit të detyrueshëm psikiatrik me ndalim dhe pozita e personave ndaj të cilëve ekzekutohet kjo masë rregullohet me dispozitat e neneve 16-24 të kësaj rregulloreje. Sipas nenit 16 masa e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik me ndalim ekzekutohet në institucionin e kujdesit shëndetësor që ndodhet në vendbanimin e përhershëm apo vendqëndrimin e të pandehurit, ose nëse institucioni i tillë nuk ndodhet në atë vend, në institucionin më të afërt me vendin ku i pandehuri e ka vendbanimin e përhershëm apo vendqëndrimin apo në vendin ku është zbatuar procedura penale. Duke u nisur nga fakti se kemi të bëjmë me persona të cilët janë me çrregullime mendore, dhe se mund të paraqesin rrezik për mjedisin e caktuar shoqëror, atëherë, me rastin e vendosjes kjo rrethanë duhet të merret parasysh. Po ashtu, dispozitat e kësaj rregulloreje shtrojnë nevojën që me rastin e vendosjes të merret parasysh edhe vendbanimi i përhershëm apo vendqëndrimi i të pandehurit si dhe nevojat e tij për trajtim. Duke u nisur nga karakteri dhe qëllimi i masave të trajtimit të detyrueshëm psikiatrik, dispozitat e kësaj rregulloreje i japin prioritet ekzekutimit të kësaj mase ndaj ekzekutimit të dënimit me burgim. Kjo mund të vërehet mjaft mirë në nenin 17 ku shprehimisht thuhet: *"Nëse masa është shqiptuar së bashku me dënimin me burgim, kryerësi i veprës penale së pari dërgohet në institucionin e kujdesit shëndetësor"*. Parimisht, personi ndaj të cilit ekzekutohet masa e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik me ndalim ka të drejta dhe detyrime të njëjta sikurse personi i cili e mban dënimin me burgim, por, kuptohet, nëse nevojat e trajtimit të tij nuk kërkojnë ndryshe (neni 19 paragrafi 1). Sikurse edhe për personat që e mbajnë dënimin me burgim që mund të transferohen nga një institucion korrektues në tjetrin, edhe personat me këtë masë të trajtimit të detyrueshëm mund të transferohen nga një institucion i kujdesit shëndetësor në tjetrin, në bazë të propozimit të institucionit të kujdesit shëndetësor, dhe nëse ekzistojnë arsyet për një transferim të tillë.

Në krahasim me legjislacionin e mëparshëm, përveç shumë risive dhe zgjidhjeve të avancuara që janë miratuar me këtë rregullore, si risi që ka ardhur në shprehje duhet përmendur edhe obligimin e monitorimit të ekzekutimit të kësaj mase nga ana e gjykatës dhe të organit publik kom-

petent për shëndetësi. Sipas nenit 20 të kësaj rregulloreje, gjykata që ka shqiptuar masën në shkallë të parë monitoron ligjshmërinë e ekzekutimit të saj, ndërsa organi publik për shëndetësi monitoron aftësinë profesionale të trajtimit i cili ofrohet gjatë ekzekutimit të masës. Derisa me legjislacionin e mëparshëm institucioni-spital kishte për detyrë që të paktën një herë në vit të njoftojë gjykatën lidhur me gjendjen shëndetësore të personit të cilit i është shqiptuar kjo masë,¹³ tash me këtë rregullore kjo periudhë kohore është dukshëm më e shkurtër. Respektivisht, sipas nenit 21 të kësaj rregulloreje, institucioni i kujdesit shëndetësor i dërgon gjykatës që ka shqiptuar masën në shkallë të parë raport mbi gjendjen shëndetësore dhe suksesin e trajtimit të personit ndaj të cilit ekzekutohet masa së paku një herë në gjashtë muaj dhe më shpesh me kërkesë të gjykatës. Po ashtu, është obligim i gjykatës e cila ka shqiptuar masën në shkallë të parë që për çdo gjashtë muaj të shqyrtojë nevojën e vazhdimin të masës pas shqyrtimit të raportit të institucionit shëndetësor dhe të mendimit të ekspertit të pavarur i cili nuk është i punësuar në institucionin ku ekzekutohet masa (neni 21 paragrafi 3). Sipas paragrafit 4 të këtij neni, sipas detyrës zyrtare ose me propozim të të pandehurit, të mbrojtësit, të institucionit të kujdesit shëndetësor ose të organit kompetent të kujdestarisë, gjykata e cila ka shqiptuar masën në shkallë të parë e pushon masën nëse konstaton se nuk është më tej e nevojshme që kryerësi të trajtohet apo ndalet në institucion. Nëse e pushon masën, gjykata mund ta shqyrtojë masën e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik në liri nëse ekzistojnë arsyet për një masë të tillë.

Në nenin 24 të kësaj rregulloreje trajtohet edhe lirimi nga institucioni i kujdesit shëndetësor i kryerësit i cili ka kryer vepër penale në gjendje të aftësisë së zvogëluar mendore. Sipas këtij neni, nëse kryerësi i tillë ka kaluar kohë më të shkurtër në institucionin e kujdesit shëndetësor se sa kohëzgjatja e burgimit të shqiptuar, atëherë gjykata e shqyrton mundësinë e lirimit me kusht për personin e tillë. Në rastin e tillë, gjykata e cila vendos lidhur me lirimin me kusht merr parasysh suksesin e trajtimit të personit të dënuar, gjendjen e tij shëndetësore, kohën e kaluar në institucionin shëndetësor dhe kohën e mbetur të dënimit. Nëse gjykata vendos për lirimin me kusht, ajo mundet po ashtu të shqyrtojë masën e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik në liri, nëse ekzistojnë arsyet për shqiptimin e kësaj mase.

Ekzekutimi i masës së trajtimit të detyrueshëm psikiatrik në liri dhe pozita e personave që i nënshtrohen ekzekutimit të kësaj mase rregullohet me dispozitat e neneve 25-28 të kësaj rregulloreje. Sipas nenit 25 paragrafi

¹³ Shih nenin 231 të Ligjit mbi ekzekutimin e sanksioneve penale të vitit 1977.

1, masa e trajtimit të deturueshëm psikiatrik në liri ekzekutohet në institucionin e kujdesit shëndetësor të caktuar nga gjykata që e ka shqiptuar masën në shkallën e parë. Për ndryshim nga masa e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik me ndalim, kjo masë ekzekutohet në atë mënyrë që i mundëson personit të qëndrojë në liri dhe të paraqitet në institucionin e kujdesit shëndetësor për trajtim brenda kohës së caktuar nga gjykata. Institucioni i kujdesit shëndetësor e njofton gjykatën lidhur me gjendjen shëndetësore dhe suksesin e trajtimit të personit ndaj të cilit ekzekutohet kjo masë së paku një herë në gjashtë muaj dhe me kërkesë të gjykatës edhe më shpesh.¹⁴ Në pajtim me nenin 26 paragrafi 3 të kësaj rregulloreje, gjykata e cila e ka shqiptuar masën në shkallë të parë, sipas detyrës zyrtare apo me propozimin e të pandehurit, mbrojtësit, institucionit të kujdesit shëndetësor ose organit kompetent të kujdestarisë, e pushon masën nëse konstaton se më nuk është e nevojshme të trajtojë kryerësin e veprës penale. Është obligim i institucionit të kujdesit shëndetësor që ta njoftojë gjykatën e cila e ka shqiptuar masën në shkallën e parë kur kryerësi nuk i është nënshtruar trajtimit në liri, nëse ai arbitrarisht e ka ndërprerë trajtimin ose nëse çmon se trajtimi ka qenë i pasuksesshëm. Në rastet e tilla gjykata ka mundësi që ta shqiptojë masën e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik me ndalim. Respektivisht, sipas nenit 27 paragrafi 2, gjykata, sipas detyrës zyrtare ose me propozimin e institucionit të kujdesit shëndetësor në të cilën personi trajtohet apo duhet të trajtohet, mund të shqiptojë masën e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik me ndalim nëse: *“a) Kryerësi nuk i është nënshtruar trajtimit në liri, ka ndërprerë trajtimin arbitrarisht ose kur trajtimi është konsideruar i pasuksesshëm nga institucioni i kujdesit shëndetësor; dhe b) Ekzistojnë arsyet për shqiptimin e masës së tillë”*. Natyrisht se një vendim të tillë gjykata mund ta marrë pas dëgjimit të prokurorit, mbrojtësit dhe kryerësit të veprës penale, nëse këtë e lejon gjendja e tij, dhe pas shqyrtimit të mendimit të ekspertit të pavarur.

Në kapitullin VIII të kësaj rregulloreje gjenden dispozitat kalimtare (nenet 29-32), të cilat kanë të bëjnë me procedurat paraprake të inicuar dhe të propozimeve për procedurat për shqiptimin e masave siguroese para hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje, si dhe me rishikimin e masave siguroese dhe zbatimin e dispozitave për ekzekutimin e kësaj rregulloreje ndaj personave kundër të cilëve janë duke u ekzekutuar masat siguroese. Ndërkaq, në kapitullin IX dhe të fundit të kësaj rregulloreje gjenden

¹⁴ Derisa sipas legjislacionit të mëparshëm kjo masë nuk ka mundur të zgjasë më tepër se dy vjet (neni 64 parag. 4 i Ligjit Penal të ish-RSFJ-së), me dispozitat e kësaj rregulloreje nuk parashihet kohëzgjatja e ekzekutimit të kësaj mase. Kohëzgjatja e saj varet nga sukcesi i arritur gjatë trajtimit të personit ndaj të cilit ekzekutohet kjo masë.

dispozitat përfundimtare (nenet 33-34), të cilat kanë të bëjnë me zbatimin e legjislacionit tjetër. Sipas nenit 33, dispozitat e Kodit të Përkohshëm Penal, të Kodit të Përkohshëm të Procedurës Penale të Kosovës, Ligjit për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale dhe cilitdo ligj tjetër relevant zbatohen për kryerësit me çrregullime mendore, përveç nëse është përcaktuar ndryshe me këtë Rregullore.

Summary

Rregullorja nr.2004/34 "Mbi procedurën penale ku përfshihen kryerës me çrregullime mendore" e cila është shpallur më 24 gusht 2004 ka një rëndësi të madhe për sistemin juridiko-penal, procedural dhe atë penitenciar të Kosovës. Me këtë rregullore për herë të parë në historinë e Kosovës rregullohet në mënyrë të pavarur fusha e trajtimit të pozitës së kryerësve të veprave penale me çrregullime mendore. Kjo rregullore përmban dispozita të natyrës penale materiale, të procedurës penale dhe të ekzekutimit të masave të trajtimit të detyrueshëm psikiatrik ndaj kryerësve me çrregullime mendore. Me këtë rregullore janë përfshirë shumë zgjidhje parimore dhe solucione nga dispozitat e legjislacioneve të shteteve të zhvilluara bashkëkohore. Po ashtu, me të janë miratuar edhe një mori standardesh dhe kërkesash të disa konventave dhe akteve të njohura ndërkombëtare, të cilat u referohen pozitës së kryerësve me çrregullime mendore. Kjo rregullore është e sistemuar në nëntë kapituj si vijon: Dispozitat e përgjithshme; Masat e zbatueshme për kryerësit me paaftësi mendore ose me aftësi të zvogëluar mendore; Procedura paraprake; Procedura në rastin e paaftësisë për t'iu nënshtruar gjykimit; Procedura për rastet e paaftësisë mendore në kohën e kryerjes së veprës penale; Procedura në rastin e aftësisë së zvogëluar mendore në kohën e kryerjes së veprës penale; Ekzekutimi i masave për trajtim të detyrueshëm psikiatrik; Dispozitat kalimtare; Dispozitat përfundimtare. Dispozitat e kësaj rregulloreje përshkohen me parimin e humanizmit dhe avancimin e pozitës së kryerësve me çrregullime mendore konform standardeve dhe kërkesave bashkëkohore.